



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
PROKURORIA E PERGJITHSHME



4

Nr 21 date 13/02/2001

Për instalimin e programit 'DOSJA 2000', ne Prokurorinë e Përgjithshme dhe ne rrethe

Unë, Arben Rakipi, Prokuror i Përgjithshëm i Republikës, me qellim instalimin e programit **Dosja 2000** ne Prokurorinë e Përgjithshme dhe ne rrethe si dhe për përmirësimin e mëtejshëm te punës te Informatike - Statistikës ne Prokurorinë e Përgjithshme,

**URDHËROJ:**

1. Brenda muajit Shkurt 2001 te instalohet programi **Dosja 2000**, ne Prokuroritë e rretheve, Elbasan, Durrës, Kavajë dhe Lushnjë si prove eksperimentale.
2. Prokuroritë e rretheve te mësipërme te marrin te gjitha masat qe brenda muajit Mars 2001 te përfundojnë regjistrimin e procedimeve penale te mbartura nga viti 2000 si dhe te gjitha procedimet penale te reja për vitin 2001.
3. Brenda datës 16 Prill 2001 shërbimi i informatikës ne Prokurorinë e Përgjithshme te beje analizën e punës për regjistrimin dhe përpunimin e te dhënave te krijuara nga rrethet Elbasan, Durrës, Lushnjë, Kavajë, dhe mbi ketë baze ne bashkëpunim me firmën e programimit te bëjnë korrigjimet dhe shtesat e nevojshme për problemet e dala gjate punës me programin '**Dosja 2000**'.
4. Gjate muajve Maj-Qershor 2001 shërbimi i informatikës ne Prokurorinë e Përgjithshme te përfundoje instalimin e programit, '**Dosja 2000**' ne te gjitha Prokuroritë e rretheve qe kane rrjete kompjuterik.
5. Prokuroritë e rretheve ku do te instalohet programi **dosja 2000**, te fillojnë menjëherë nga puna për hedhjen (regjistrimin) e procedimeve penale për vitin 2001 e ne vazhdim.
6. Për ndjekjen dhe realizimin ne vazhdimësi te detyrave te mësipërme caktohet dega e informatike-statistikës ne Prokurorinë e Përgjithshme. Ne dispozicion te kësaj dege te vihet automjeti Tipo me targe TR 7235 (ish makina e drejtorisë se personelit). Si shofer për drejtimin e këtij automjeti te jete tekniku i kompjuterëve Agron Mema.
7. Ky urdhër hynë ne fuqi menjëherë.

PROKUROR I PERGJITHSHEM  
ARBEN RAKIPI

